STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 7 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) PERGEZON PERPJEKJET E FEDEX PER TE MBESHTETUR PERPJEKJET PER NDIHME PER URAGANIN

Ndërmarrjet që përdor FedEx dërgojnë automjete të flotës për të çuar ujë, ushqim dhe gjeneratorë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) përgëzoi sot përpjekjet e FedEx për të mbështetur përpjekjet e ndihmës për katastrofën e Uraganit Sendi (Hurricane Sandy) duke çuar gjeneratorë, ushqime, ujë dhe akull tek azilet e pleqve, strehat, reaguesit e parë dhe organizata të tjera të ndihmës anembanë luginës së poshtme Hadson, Qytetit të Nju Jorkut dhe Long Ajlënd.

"Përpjekjet e bamirësisë nga sektori privat si ato të FedEx janë mëse të mirëpritura ndërsa komunitetet tona punojnë për t'u rimëkëmbur nga shkatërrimi i shkaktuar nga Uragani Sendi (Hurricane Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Që nga dita e pare e kësaj katastrofe, FedEx ka qënë duke ndihmuar në çuarjen e sendeve të rëndësishme tek shtetasit e Nju Jorkut në nevojë shpejt dhe menjëherë pas stuhisë dhe i falënderoj për shërbimin e tyre bujar."

Si reagim ndaj Uraganit Sendi (Sandy), FedEx dërgoi disa prej kamionave të furnizimit të flotës vendore të tij, kamiona të mëdhenj dhe automjete të tjera për të çuar sende të rëndësishme si ujë, akull të thatë dhe më shumë se 85 gjeneratorë mjaft të nevojshëm në streha, azile të pleqve, stacione të zjarrfikësave dhe infrastrukturën e rendësishme që mbron furnizimet me ujë anembanë rajonit të pjesës së poshtme të shtetit, përfshirë qarqet e Nasaut, Oranxhit, Safolkut dhe Uestçesterit. Perveç kësaj, FedEx çoi një gjenerator masiv prej 500 kilovatësh në Aeroportin LaGuardia për të ndihmuar në përpjekjet e tij për të pastruar dhe rifilluar nga funksionimi.

Ndërmarrjet që përdor FedEx gjithashtu kanë transportuar sende të rëndësishme përfshirë më shumë se 23,000 MRE (Ushqime gati për t'u ngrënë) nga Qarku Oneida si dhe një gjenerator të madh dhe qindra pajisje trafiku, si fuçi portokalli dhe barrikada, në një karroceri 53 këmbë të gjatë në një zonë të madhe të përgatitjes të reagimit ndaj emergjencës në Siti Filld në Kuins.

Çuarja e këtyre sendeve vazhdon të mbështesë përpjekjet e ndihmës anembanë rajonit të pjesës së poshtme të shtetit, duke ndihmuar për të përmbushur nevojat thelbësore të shtetasve të Nju Jorkut të prekur nga uragani, si për ushqime, ngrohje dhe ujë të rrjedhshëm, të pastër.

“FedEx është krenar që është në gjendje të mbështesë përpjekjet për ndihmë për Uraganin Sendi (Hurricane Sandy),” tha Frederik W. Smith, kryetar, president dhe CEO i FedEx Corp. “Anëtarët e ekipit tonë gjithnjë i janë përgjigjur thirrjes kur ndodhin katastrofa dhe kemi nderin që të japim një dorë ndihmë për miqtë tanë në verilindje.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418